



Justiz- und Sicherheitsdepartement des Kantons Basel-Stadt

Programi mësimor kundër dhunës në shtëpi

Një ofertë për burra dhe gra nga kantoni Basel-Stadt për një jetë pa dhunë në familje dhe në raporte çiftësh



A ju kujtohen situata të tilla?

Gjatë grindjes me partnerin apo partneren tuaj ose me fëmijët tuaj...

...keni frikë të humbni kontrollin mbi vetveten dhe ndiheni të mbingarkuar.

...tashme keni bërë titur, ofenduar ose kërcënuar.

...tashme keni shtyrë lehtë ose fortë, keni pështyrë, rrahur, mbytur ose keni frikë, që të bëni veprime të tilla.

...tashme keni shkatërruar sende ose ua keni hedhur të tjerëve.

...ndjeni, që njerëzit përreth jush ju afrohen juve me frikë.

Edhe nëse vetëm njëra e këtyre pikave është e saktë për ju: Merrni këtë temë seriozisht. Mbroni të afërmit tuaj! Nga dhuna vuajnë të gjithë, posaçërisht edhe fëmijët, që e përjetojnë këtë dhunë drejtpërsëdrejti apo në mënyrë indirekte. Dhuna në shtëpi është një rëndesë e madhe për zhvillimin e fëmijëve.

Bëni ju hapin e parë në një të ardhme pa dhunë!

Merrni pjesë në programin mësimor kundër dhunës në shtëpi. Efekti ndihet: Njerëzit, që marrin pjesë në programin mësimor, më rrallë i rikthehen dhunës. Pjesëmarrëset dhe pjesëmarrësit e dinë, se çfarë pasojash sjell dhuna e tyre, se çfarë e shkakton dhe se si ata mund ta parandalojnë atë. Kursi zhvillohet nga persona të specializuar me përvoja prej vitesh në fushën e dhunës në shtëpi.

Kush mund të marrë pjesë në programin mësimor?

Programi mësimor u drejtohet personave të moshës madhore, të cilët kanë ushtruar dhunë ose kanë kërcënuar me dhunë në një partneritet ekzistues apo të ndarë ose në familje.

Pas regjistrimit bëhet një bisedë pranuese me personat, që e ofrojnë kursin. Për pjesëmarrësit me një gjuhë të huaj amtare punohet me një përkthim. Oferta është falas.

Çfarë janë objektivat e programit mësimor?

- Ju njiheni me mostrat tuaja individuale të dinamikës së dhunës.
- Ju njiheni me rrezikun tuaj për t'u bërë përsëritës dhe përpiloni strategji kundër përsëritjeve.
- Ju mësoni të grindeni dhe të bisedoni pa dhunë.
- Ju nxitni perceptimin e vetvetes dhe të të tjerëve.
- Ju fitoni siguri në aftësitë e reja, që mësuat.

Regjistrimi:

Për të pajtuar një termin për bisedën pranuese drejtohuni:

Abteilung Gewaltschutz und Opferhilfe

Telefoni: +41 (0)61 267 44 90

E-maili: haeusliche-gewalt@jsd.bs.ch

Autoritetet shtetërore, të cilat regjistrojnë një person për programin mësimor, i dërgojnë gjithë dokumentacionin relevant departamentit të mbrojtjes nga dhuna dhe të ndihmës për viktimat (Abteilung Gewaltschutz und Opferhilfe).

Botuar nga:

Justiz- und Sicherheitsdepartement Basel-Stadt

Generalsekretariat

Abteilung Gewaltschutz und Opferhilfe

Spiegelgasse 6, 4001 Basel

www.halt-gewalt.bs.ch

Redaktimi dhe faqosja: bom! communication ag

© 2023